



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR ENERGJINË TERMIKE**

**DRAFT LAW ON THERMAL ENERGY**

**NACRT ZAKONA O TOPLOTNOJ ENERGIJI**

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR ENERGJINË TERMIKE</b></p> <p><b>KAPITULLI I</b> <b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë termike për ngrohje/ftohje të përqendruar, sipas ekonomisë së tregut të lirë, plotësimi të kërkesës së konsumatorit dhe mbrojtjes së mjedisit, furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient me energji termike, për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial konsumatorët që të gëzojnë të drejtë për t'u kyçur në sistemet e energjisë termike dhe për t'u furnizuar me energji termike sipas standardeve dhe me çmim ekonomik.</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Based on Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p><b>LAW ON THERMAL ENERGY</b></p> <p><b>CHAPTER I</b> <b>GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>1. The purpose of this law is defines the conditions for the development of a sustainable and competitive market of thermal energy for heating/cooling, in line with a market economy, fulfilling customer demand and protecting the environment a safe, sustainable and efficient thermal energy supply, for the cooling/heating of spaces, heating of sanitary and industrial water customers to enjoy the right to connect thermal energy systems and be supplied with thermal energy in line with applicable standards and affordable price.</p>	<p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON O TOPLOTNOJ ENERGIJI</b></p> <p><b>POGLAVLJE I</b> <b>OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1</b> <b>Cilj</b></p> <p>1. Cilj ovog zakona definiše uslove za razvoj stabilnog i konkurentnog tržišta za centralno o toplotnoj energiji grejanje/hlađenje, u slobodnoj tržišnoj privredi, na osnovu ekonomije slobodnog tržišta, zadovoljavanje potreba potrošača i zaštitu životne sredine; sigurno, održivo i efikasno snabdevanje toplotnom energijom za grejanje/hlađenje prostora, grejanje sanitarne vode i industrijske vode korisnici uživaju pravo da se priključe u sistemima toplotnom energijom i da se snabdevaju toplotnom energijom u skladu sa standardima i po ekonomskoj ceni.</p>
--	--	--

<p>2. Ky Ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën Nr. 2009/28/EC lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme.</p>	<p>2. This law is partially in compliance with the No. 2009/28/EC concerning promotion of use of energy from renewable sources.</p>	<p>2. Ovaj zakon je delimično u skladu sa Direktiva Br. 2009/28/EC u vezi sa promovisanjem korišćenja energije iz obnovljivih izvora.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p>
<p>Me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe standardet për kryerjen e aktiviteteve energjetike të prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike, përmes sistemeve qendrore të energjisë termike, organizimin e tregut të energjisë termike dhe qasjen në rrjet, si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që veprojnë sipas këtij ligji.</p>	<p>This law establishes the conditions and standards to conduct energy activities of thermal energy generation, transportation, distribution and supply, through central thermal energy systems, organization of the thermal energy market and access to the network, and rights and obligations of entities operating under this law.</p>	<p>Ovim zakonom utvrđuju se uslovi i standardi za obavljanje energetske aktivnosti proizvodnje, distribucije i snabdevanja toplotnom energijom preko centralnih sistema za toplotnu energiju, organizacija tržišta toplotne energije i pristup mreži, kao i prava i obaveze subjekata koji posluju po ovom zakonu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p>
<p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Bashkëprodhimi</b> - nënkupton procesin e prodhimit të njëkohshëm të energjisë elektrike dhe termike nga një burim energjetik gjatë të njëjtit proces teknologjik;</p> <p>1.2. <b>Certifikata e origjinës</b> – dokument</p>	<p>1. Terms and expressions used in this law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Cogeneration</b> – means the process of simultaneous generation of electricity and thermal energy from the same energy source during the same technological process.</p> <p>1.2. <b>Certificate of origin</b>– an</p>	<p>1. Izrazi koji se koriste u ovom Zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. <b>Suproizvodnja</b> – podrazumeva proces istovremene proizvodnje električne i toplotne energije iz energetske izvora tokom istog tehnološki proces.</p> <p>1.2. <b>Sertifikat o poreklu</b> – dokument</p>

<p>i formës elektronike, që lëshohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që ka funksionin e shitjes, me qëllim të ofrimit si provë tek konsumatori fundor që një pjesë e caktuar e energjisë termike është prodhuar nga burimet e ripërtëritshme;</p> <p><b>1.3. Energji termike</b> – nënkupton energjinë për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial, që transportohet dhe shpërndahet përmes ujit, avullit, ose gazrave, e përfituar nga stabilimentet e energjisë termike, duke përdorur lëndët djegëse, burimet gjeotermale, energjinë solare, energjinë termike të pashfrytëzuar, me të cilën furnizohen konsumatorët përmes sistemeve qendrore të energjisë termike;</p> <p><b>1.4. Energji termike e pashfrytëzuar</b> – nënkupton energjinë termike të prodhuar në impiantet e proceseve teknologjike dhe termocentrale, e cila nuk shfrytëzohet, respektivisht është e humbur, e që me rritje të efikasitës së proceseve, ka mundësi të përdoret për ngrohje/ftohje;</p> <p><b>1.5. Energjia termike nga mbeturinat</b> – nënkupton energjinë termike të fituar me djegien e mbeturinave që mund të përdoren për ngrohje/ftohje;</p>	<p>electronic document issued by the Energy Regulatory Office which has the sole function of providing the proof to a final customer that a given share or quantity of energy was produced from renewable sources;</p> <p><b>1.3. Thermal energy</b> – means energy for heating/cooling, spaces, sanitary hot water and industrial water that transported and distributed through water, steam or gases, benefited from thermal energy facilities, using fuel, geothermal sources, solar energy, unused thermal energy, to supply for customers through central thermal energy systems;</p> <p><b>1.4. Unused thermal energy</b> – means thermal energy generated in technological plants and power plants, which is not used, respectively it is lost, and which could be used through an enhanced process efficiency for heating/cooling;</p> <p><b>1.5. Thermal energy from waste</b> – means thermal energy obtained through the combustion of waste which can be used for heating/cooling;</p>	<p>elektronskog oblika koji izdaje Regulatorni ured za Energiju koji ima funkciju prodaje u cilju pružanja kao dokaza kod krajnjeg potrošača da je određeni do toplotne energije proizveden od obnovljivih izvora;</p> <p><b>1.3. Toplotna energija</b> – mislim energiju za grejanje / hlađenje prostora , sanitarne tople vode i industrijske vode koja se prenosi i distribuira vodom, parom ili gasom dobijenu u postrojenjima za toplotnu energiju korišćenjem goriva, geotermalnih izvora, solarne energije, neiskorišćene toplotne energije kojom se snabdevaju potrošači preko centralnih sistema za toplotnu energiju;</p> <p><b>1.4. Neiskorišćena toplotna energija</b> – označava toplotnu energiju proizvedenu u pogonima tehnoloških procesa i hidroelektranama, koja se ne koristi, odnosno koja se gubi, a koja bi se povećanjem efikasnosti procesa mogla koristiti za grejanje/hlađenje;</p> <p><b>1.5. Toplotna energija od otpada</b> – označava toplotnu energiju dobijenu sagorevanjem otpada a koja se može koristiti za grejanje/hlađenje;</p>
---	---	--

<p>1.6. <b>Fluidi-bartës i energjisë termike</b> – nënkupton ujin e ngrohët, avullin, avullin e ngopur, lëngjet e tjera ose gazrat që përdoren për të transportuar energjinë termike përmes rrjetit të shpërndarjes;</p> <p>1.7. <b>Furnizim</b> – nënkupton shitjen përfshirë rishitjen e energjisë termike tek konsumatorët;</p> <p>1.8. <b>Furnizuesi publik</b> – nënkupton ndërmarrjen e energjisë termike e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të kryer veprimtarinë e furnizimit publik;</p> <p>1.9. <b>Furnizimi publik</b> – nënkupton furnizimin e konsumatorëve fundorë me energji termike me tarifa të rregulluara në pajtim me nenin 17, 18, 19 të këtij ligji;</p> <p>1.10. <b>Furnizuesi</b> – nënkupton ndërmarrjen e energjisë termike të licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit;</p> <p>1.11. <b>Kodi i shpërndarjes</b> – nënkupton përmbledhje të rregullave teknike dhe procedurave për operimin, mirëmbajtjen, planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të</p>	<p>1.6. <b>Thermal Energy transfer fluid</b> – means hot water, saturated steam, other fluids or gases which are used to transport thermal energy through the distribution network;</p> <p>1.7. <b>Supply</b> – means the sale including resale of thermal energy to the consumers;</p> <p>1.8. <b>Public supplier</b> – means a thermal energy enterprise licensed by the Energy Regulatory Office to carry out the activity of public supply;</p> <p>1.9. <b>Public supply</b> – means the supply of thermal energy to final customers at regulated tariffs in accordance with article 17, 18, 19 of this Law;</p> <p>1.10. <b>Supplier</b>– means the thermal energy enterprise licensed to perform supply activities;</p> <p>1.11. <b>Distribution Code</b> – means a summary of technical rules and procedures for operation, maintenance, planning and development of the distribution system</p>	<p>1.6. <b>Fluid/tečnost – prenosnik toplotne energije</b> – označava toplu vodu, paru, zasićenu paru i druge tečnosti ili gasove koji se koriste za prenošenje toplotne energije kroz distributivnu mrežu;</p> <p>1.7. <b>Snabdevanje</b> – označava prodaju ili preprodaju toplotne energije potrošaču;</p> <p>1.8. <b>Javni snabdevaç</b> – označava termoenergetsko preduzeće licencirano do strane Regulatorna Kancelarija za Energetiku za obavljanje delatnosti javnog snabdevanja;</p> <p>1.9. <b>Javno snabdevanje</b> – označava snabdevanje krajnjih potrošača toplotnom energijom po regulisanim tarifama u skladu sa članovima 17, 18, 19 ovog zakona.</p> <p>1.10. <b>Snabdevaç</b> – označava termoenergetsko preduzeće licencirano za obavljanje delatnosti snabdevanja;</p> <p>1.11. <b>Distributivni kodeks</b> – označava skup tehničkih pravila i procedura za upravljanje, održavanje, planiranje i razvoj distributivnog</p>
--	---	--

<p>shpërndarjes, si dhe kyçjen në sistemin e shpërndarjes së energjisë termike;</p> <p>1.12. <b>Kodi i matjes</b> – nënkupton përmbledhje të rregullave dhe procedurave që përcaktojnë mënyrën e leximit të njehsorëve (matësve), llogaritjes së energjisë termike të shpenzuar dhe faturimit në sektorin e energjisë termike;</p> <p>1.13. <b>Konsumator</b> – nënkupton personin juridik ose fizik që furnizohet me energji termike, në këtë mënyrë konsumatori mund të jetë ose përdoruesi i fundit, ose një person fizik apo juridik që furnizon me energji termike konsumatorin e fundit;</p> <p>1.14. <b>Konsumatori fundor</b> - nënkupton shpenzuesin e energjisë termike për përdorim vetanak;</p> <p>1.15. <b>Konsumator me prioritet furnizimi</b> – konsumatori që ka prioritet në furnizim me energji termike siç janë spitalet, shkollat dhe çerdhet;</p> <p>1.16. <b>Licencë</b> – nënkupton dokumentin e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që mundëson bartësit të licencës të ushtrijë aktivitete në sektorin e</p>	<p>development, and connection in the thermal energy distribution system;</p> <p>1.12. <b>Metering Code</b> – means a summary of technical rules and procedures that define the reading of meters, calculation of used thermal energy and billing in the thermal energy sector;</p> <p>1.13. <b>Customer</b> – means a legal or natural person supplied with thermal energy, which can be an end-consumer, or a legal or natural person supplying the end consumer with thermal energy;</p> <p>1.14. <b>Final consumer</b> – means a user thermal energy for own consumption;</p> <p>1.15. <b>Priority supply consumer</b> – consumers that enjoy priority in supply of thermal energy, such as hospitals, schools, and kindergartens;</p> <p>1.16. <b>License</b> – means the document issued by the Energy Regulatory Office, which enables the licensee to exercise energy sector activities for which a</p>	<p>sistema, kao i priključenje na distributivni sistem toplotne energije;</p> <p>1.12. <b>Merni kodeks</b> – označava skup pravila i procedura kojima se utvrđuje način očitavanja brojila, obračuna potrošene toplotne energije i fakturisanje u sektoru toplotne energije;</p> <p>1.13. <b>Potrošač</b> – označava pravno ili fizičko lice koje se snabdeva toplotnom energijom, tako da potrošač može da bude krajnji potrošač ili fizičko ili pravno lice koje snabdeva krajnjeg potrošača toplotnom energijom;</p> <p>1.14. <b>Krajnji potrošač</b> – je potrošač toplotne energije za sopstvene potrebe;</p> <p>1.15. <b>Potrošač sa prioritetom u snabdevanju</b> – potrošač koji ima prioritet u snabdevanju toplotnom energijom, kao što su bolnice , škole, vrtiće i;</p> <p>1.16. <b>Licenca</b> – podrazumeva dokumenat koji izdaje Regulatorna Kancelarija za Energetiku, koji omogućava imaoću licence da obavlja</p>
--	---	---

<p>energjisë për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë;</p> <p>1.17. <b>Ministria</b> – nënkupton Ministrinë përkatëse për sektorin e energjisë.</p> <p>1.18. <b>Ndërmarrjet e energjisë termike</b> – nënkupton subjektin që përmbush një ose më shumë aktivitete të prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike, bazuar në licencën e dhënë, ashtu si dhe prodhuesit e energjisë termike që janë të kyçur në sistemin e energjisë termike, e që janë të përjashtuar nga licenca, siç përcaktohet në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;</p> <p>1.19. <b>Nënstacioni i energjisë termike</b> – qark pajisjesh për qarkullim dhe rregullim të dërgimit të energjisë termike, pa shkëmbyes të energjisë termike, i cili është pjesë përbërëse e instalimeve të brendshme të konsumatorëve fundor dhe është e vendosur brenda ndërtesës;</p> <p>1.20. <b>Ngrohje/ftohje e përqendruar</b> – nënkupton energjinë termike që transportohet përmes fluidit-bartës të energjisë termike nga prodhuesi deri tek</p>	<p>license is required, pursuant to the provisions of laws regulating the energy sector.</p> <p>1.17. <b>Ministry</b> – means the Ministry responsible for the energy sector.</p> <p>1.18. <b>Thermal energy enterprises</b> – means a legal entity which fulfills one or more thermal energy generation, transportation, distribution and supply activity, based on the license issued, as well as thermal power producers which are connected in the thermal energy systems, which are exempt from licenses, as defined in the Law on the Energy Regulator;</p> <p>1.19. <b>Thermal energy substation</b> – circle of equipment for circulation and regulation of transfer of thermal energy, without thermal energy exchangers, which is an integral part of internal installations of final consumers, placed within the building.</p> <p>1.20. <b>District heating/cooling</b>– means thermal energy which is transported through a thermal energy transfer fluid from the generator to the consumer,</p>	<p>delatnosti u energetsom sektoru za koje je neophodna licenca u skladu sa odredbama zakona koji uređuju energetske sektor;</p> <p>1.17. <b>Ministarstvo</b> – je ministarstvo nadležno za energetske sektor.</p> <p>1.18. <b>Termoenergetsko preduzeće</b> – označava lice koje obavlja jednu ili više delatnosti proizvodnje, prenosa, distribucije i snabdevanja toplotnom energijom na osnovu dodeljene licence, kao i proizvođače toplotne energije koji su priključeni na termoenergetski sistem, koji su oslobođeni licence, kao što je utvrđeno u Zakonu o Energetskom Regulatoru;</p> <p>1.19. <b>Podstanica za toplotnu energiju</b> -kolo opreme za promet i regulisanje odašiljanja toplotne energije, bez postrojenja za razmenu toplotne energije, koji je sastavni deo unutrašnjih instalacija krajnjih potrošača i smešten je u zgradi.</p> <p>1.20. <b>Centralno grejanje / hlađenje</b> – označava toplotnu energiju koja se prenosi tečnošću za prenos toplotne energije od proizvođača do potrošača</p>
--	--	--

<p>konsumatori, përmes rrjetit të shpërndarjes, për qëllim të ngrohjes/ftohjes së hapësirave të banimit dhe afariste në nivelin e kërkuar, si dhe ngrohjen e ujit sanitar dhe industrial;</p> <p><b>1.21. Ndërmarrje e energjisë termike vertikalisht e integruar</b> – nënkupton ndërmarrjen e energjisë termike që kryen prodhimin, transportimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji termike;</p> <p><b>1.22. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes</b> - nënkupton personin juridik ose fizik të licencuar, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transportimit dhe shpërndarjes së energjisë termike;</p> <p><b>1.23. Pajisjet matëse</b> – instrumente të regjistruara në regjistrin e pajisjeve matëse të certifikuara në Republikën e Kosovës, që përdoren për matje të energjisë së prodhuar, transmetuar, shpërndarë, furnizuar dhe të konsumuar;</p> <p><b>1.24. Pika furnizuese</b> – nënkupton nënstacionin termik prej të cilit fluidi-bartës i energjisë termike, eventualisht edhe uji i ngrohtë sanitar, i dërgohet konsumatorit fundor, ku bëhet matja e furnizimit me energji termike, me pajisje</p>	<p>through the distribution network, for the purpose of heating/cooling of residential and business spaces in the required level, and heating of sanitary and industrial water;</p> <p><b>1.21. Vertically-Integrated Thermal Energy Enterprise</b> –means the thermal energy enterprise which does generation, transportation, distribution and supply of thermal energy;</p> <p><b>1.22. Distribution System Operator</b> – means a licensed legal or natural person, responsible for the operation, maintenance, and development of the transportation and distribution system of thermal energy;</p> <p><b>1.23. Metering equipment</b> – instruments registered in the registry of certified metering equipment in the Republic of Kosovo, used for measurement of generated, transmitted, distributed, supplied and consumed energy.</p> <p><b>1.24. Supply point</b> – means the thermal substation from which the fluid thermal energy carrier, and eventually also hot sanitary water, is delivered to the final consumer, where the supply with thermal energy is metered, with relevant metered</p>	<p>kroz distributivnu mrežu za potrebe grejanja/hlađenja stambenog i poslovnog prostora na potrebnom nivou, kao i za grejanje sanitarne i industrijske vode;</p> <p><b>1.21. Vertikalno integrisano termoenergetsko preduzeće</b> - označava termoenergetsko preduzeće koje obavlja proizvodnju, prenos, distribuciju i snabdevanje toplotnom energijom;</p> <p><b>1.22. Operator Distributivnog Sistema</b> - označava licencirano fizičko ili pravno lice odgovorno za rad, održavanje i razvoj sistema prenosa i distribucije toplotne energije;</p> <p><b>1.23. Merni uređaji</b> – upisani instrumenti u registar certifikovane merne opreme u Republici Kosovo, koji se koriste za merenje proizvedene, prenošene, distribuirane, isporučene i utrošene energije;</p> <p><b>1.24. Mesto isporuke</b> – označava toplotnu podstanicu iz koje se tečnost – prenosnik toplotne energije, eventualno i topla sanitarna voda, isporučuje krajnjem potrošaču i u kojoj se vrši merenje isporuke</p>
--	--	---



<p>matëse përkatëse;</p> <p>1.25. <b>Prodhimi i energjisë termike</b> – nënkupton prodhimin e energjisë termike nga një ndërmarrje e licencuar për këtë aktivitet;</p> <p>1.26. <b>Prodhuesi</b>– nënkupton personi juridik ose fizik që prodhon energji termike;</p> <p>1.27. <b>Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike</b> – nënkupton sistemin e tubacioneve, që transportojnë dhe shpërndajnë energjinë termike nga prodhuesi deri tek konsumatori fundor , prej vendit të matjes së energjisë termike të pranuar, deri tek vendi i matjes së energjisë termike për furnizim (rrjeti i shpërndarjes, nënstacionet termike dhe njehsorëve të energjisë termike);</p> <p>1.28. <b>Sistemi i energjisë termike</b> – nënkupton sistemin teknik të përbërë nga stabilimente dhe pajisje për prodhimin e energjisë termike, nga instalimet e brendshme dhe të jashtme, që mundësojnë furnizimin me energji termike dhe mund të jetë i pavarur, i mbyllur, ose sistem qendror i energjisë termike;</p>	<p>equipment;</p> <p>1.25. <b>Generation of thermal energy</b> – means the thermal energy generation from a licensed enterprise for such an activity;</p> <p>1.26. <b>Generator</b> – means a legal or natural person who generates thermal energy;</p> <p>1.27. <b>Thermal energy distribution network</b>– means the pipeline system, which transports and distributes thermal energy from the generator to the final consumer, from the metering point of received thermal energy, to the metering point of thermal energy for supply (distribution network, thermal substations and thermal energy meters);</p> <p>1.28. <b>Thermal energy system</b> – means the technical system comprising facilities and equipment for generation of thermal energy, from internal and external installations, which enable the supply of thermal energy, and can be independent, closed, or central thermal energy systems.</p>	<p>toplotne energjië odgovarajućim mernim uređajima</p> <p>1.25. <b>Proizvodnja toplotne energije</b> – označava proizvodnju toplotne energije od strane preduzeća koje je licencirano za ovu delatnost;</p> <p>1.26. <b>Proizvođač</b> – označava pravno ili fizičko lice koje proizvodi toplotnu energiju;</p> <p>1.27. <b>Mreža za distribuciju toplotne energije</b> – označava toplovodni sistem preko kojeg se vrše prenos i distribucija toplotne energije od proizvođača do krajnjeg potrošača, od mesta merenja primljene toplotne energije do mesta merenja isporuke toplotne energije (distributivna mreža, toplotne podstanice i brojila toplotne energije);</p> <p>1.28. <b>Sistem toplotne energije</b> – podrazumeva tehnički sistem sastavljen od postrojenja i uređaja za proizvodnju toplotne energije, od unutrašnjih i spoljnih instalacija, koje omogućuju snabdevanje toplotnom energijom i može biti nezavisan, zatvoren ili centralni sistem toplotne energije</p>
--	--	--

<p>1.29. <b>Sistemi i pavarur i energjisë termike</b> - sistemi i energjisë termike i cili përbëhet nga kaldatorja, njehsorët e energjisë termike dhe instalime të brendshme, të cilat i menaxhon dhe mirëmban konsumatori i energjisë termike;</p> <p>1.30. <b>Sistemi i mbyllur i energjisë termike</b> - është sistemi termik i cili mund të përfshijë më shumë ndërtesa industriale/komerciale ose banimi, objektet që kanë një sistem të përbashkët të energjisë termike, për të cilat nuk është e nevojshme marrëveshje për koncesion;</p> <p>1.31. <b>Sistemi qendror i energjisë termike</b> – nënkupton sistemin e ndërlidhur të prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike që përcaktohet në nenin 4 të këtij ligji;</p> <p>1.32. <b>Sezoni i ngrohjes/ftohjes</b> – nënkupton periudhën e furnizimit të konsumatorëve me energji termike, varësisht nga temperatura e jashtme, i cili është i përcaktuar sipas rregullave të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;</p> <p>1.33. <b>Stacioni termik</b> - është pjesë e</p>	<p>1.29. <b>Independent thermal energy system</b> – a thermal energy system comprising the furnace, thermal energy meters and internal installations, managed and maintained by the thermal energy consumer.</p> <p>1.30. <b>Closed thermal energy system</b> – is a thermal system which may include more industrial/commercial buildings, or residential buildings, the facilities of which have a common thermal energy system, for which no concession agreements are required.</p> <p>1.31. <b>Thermal energy central system</b> – means the connected generation, transportation, distribution and supply system as defined in article 4 of this law;</p> <p>1.32. <b>Heating/cooling season</b> – means the supply period of consumers with thermal energy, depending on the external temperature, which is determined according to the rules defined by the Energy Regulatory Office;</p> <p>1.33. <b>Thermal station</b> – part of the</p>	<p>1.29. <b>Nezavisan sistem toplotne energije</b> – Sistem toplotne energije koji je sastavljen od kotla, brojila za toplotnu energiju i unutrašnjih instalacija, kojima upravlja i koje održava potrošač toplotne energije.</p> <p>1.30. <b>Zatvoren sistem toplotne energije</b> – predstavlja toplotni sistem koji može obuhvatati nekoliko industrijskih/komercijalnih ili stambenih zgrada, objekte koji imaju zajednički sistem toplotne energije, za koje nije potreban sporazum o koncesiji.</p> <p>1.31. <b>Centralizovani sistem toplotne energije</b> – označava povezani sistem proizvodnje, prenosa, distribucije i snabdevanja toplotnom energiju koji je opisan u članu 4 ovog zakona;</p> <p>1.32. <b>Sezona grejanja/hladenja</b> – označava period snabdevanja potrošača toplotnom energijom u zavisnosti od spoljašnje temperature koji je utvrđen pravilima propisanim od strane Regulatorna Kancelarija za Energetiku;</p> <p>1.33. <b>Toplotna stanica</b> – deo mreže</p>
---	---	---

<p>rrjetit të shpërndarjes, e cila përdoret për transformimin, rregullimin, ose qarkullimin e mediumit për transmetimin e energjisë termike;</p> <p>1.34. <b>Shpërndarje</b> – nënkupton procesin e transportimit dhe shpërndarjes së energjisë termike përmes rrjetit të tubacioneve tek nënstacionet termike të konsumatorëve;</p> <p>1.35. <b>Tarifa normative</b> - nënkupton sistemin e përkohshëm tarifor të energjisë termike të llogaritur për metër katror të sipërfaqes së ngrohur/ftohur;</p> <p>1.36. <b>Tarifa me matje</b> – nënkupton sistemin e përhershëm tarifor që bazohet në sasinë e shpenzuar të energjisë termike, të matur në pikën furnizuese, nga e cila furnizohet konsumatori;</p> <p>1.37. <b>Tubacioni i drejtpërdrejtë i energjisë termike</b> – nënkupton tubacionin e ngrohjes/ftohjes së përqendruar që lidh drejtpërdrejt objektet e prodhuesit me konsumatorin;</p> <p>1.38. <b>Ujë i ngrohtë sanitar</b> – nënkupton ujin e ngrohtë për amvisëri, të ngrohur së paku deri në temperaturën e përcaktuar sipas normave higjienike;</p>	<p>distribution network used for transformation, regulation or circulation of the medium for thermal energy transmission.</p> <p>1.34. <b>Distribution</b>– means the process of transportation and distribution of thermal energy through the pipeline network to the consumer’s thermal substation;</p> <p>1.35. <b>Normative tariffs</b> –means the temporary thermal energy tariff system calculated per square meter of the heated/cooled surface area;</p> <p>1.36. <b>Metered tariff</b> – means the temporary tariff system which is based on the used amount of thermal energy, metered in the supply point, supplied to the customer;</p> <p>1.37. <b>Direct pipeline of thermal energy</b> – means the concentrated district heating/cooling substation which directly connects generation facilities with the consumer;</p> <p>1.38. <b>Hot sanitary water</b> – means hot water for households, heated at least to the temperature defined by hygienic norms;</p>	<p>distribucije koja se koristi za transformaciju, uređivanje ili promet medijuma za prenos toplotne energije;</p> <p>1.34. <b>Distribucija</b> – označava proces prenosa i distribucije toplotne energije kroz mrežu cevovoda do toplotnih podstanica potrošača;</p> <p>1.35. <b>Normativna tarifa</b> – označava privremeni tarifni sistem za obračun toplotne energije po kvadratnom metru površine koja se greje/hladi;</p> <p>1.36. <b>Tarifa sa merenjem</b> – označava trajni tarifni sistem koji se zasniva na količini utrošene toplotne energije izmerene na mestu isporuke sa kojeg se snabdeva potrošač;</p> <p>1.37. <b>Direktni toplovod za toplotnu energiju</b> – označava cevovod za centralno grejanje/hlađenje koji direktno povezuje objekte proizvođača sa potrošačem;</p> <p>1.38. <b>Sanitarna topla voda</b> – označava toplu vodu za domaćinstva, zagrejanu najmanje do temperature koja je određena higijenskim normama;</p>
---	--	--

<p>1.39. <b>Zyra e Rregullatorit për Energji</b>—është agjenci e pavarur e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Gazin Natyror.</p> <p><b>KAPITULLI II SISTEMI QENDROR I ENERGJISË TERMIKE</b></p> <p><b>Neni 4 Sistemi Qendror i Energjisë Termike</b></p> <p>1. Sistemi qendror i energjisë termike përfshin njësinë e prodhimit të energjisë termike nga ndërmarrja përkatëse e licencuar, duke përfshirë termocentralet që prodhojnë energji termike nga bashkëprodhimi dhe rrjetin e shpërndarjes deri tek pika e furnizimit të konsumatorëve.</p> <p>2. Prodhuesit, duke përfshirë termocentralet që operojnë si njësi të bashkëprodhimit mund të furnizojnë me energji termike, rrjetin e njëjtë për shpërndarje të energjisë termike.</p>	<p>1.39. <b>Energy Regulatory Office</b> – An independent agency established by the Assembly of the Republic of Kosovo, in conformity with the Constitution of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Other terms used in this law shall have the meanings stipulated in the Law on Energy, the Law on Electricity, the Law on the Energy Regulator and the Law on Natural Gas.</p> <p><b>CHAPTER II THERMAL ENERGY CENTRAL SYSTEM</b></p> <p><b>Article 4 Thermal Energy Central System</b></p> <p>1. Thermal energy central system includes a thermal energy generation unit from the relevant licensed enterprise, including power plants which generate thermal energy from cogeneration and the distribution network to the point of supply for customers.</p> <p>2. Generators, including power plants which operate as a cogeneration unit, may provide supply of thermal energy to the same thermal energy distribution system.</p>	<p>1.39. <b>Regulatorna Kancelarija za Energetiku</b> – nezavisna agencija koju je obrazovala Skupština Republike Kosovo, u skladu sa Ustavom Republike Kosovo</p> <p>2. Ostali pojmovi korišćeni u ovom zakonu imaju značenje koje je utvrđeno Zakonom o enregiji, Zakonom o Električnoj Energiji, Zakonom o Energetskom Regulatoru i Zakonom o Prirodnom Gasu.</p> <p><b>POGLAVLJE II CENTRALIZOVANI SISTEM TOPLITNE ENERGIJE</b></p> <p><b>Član 4 Centralizovani Sistem Toplotne Energije</b></p> <p>1. Centralizovani sistem toplotne energije obuhvata jedinicu za proizvodnju toplotne energije od strane licenciranog preduzeća, uključujući termoelektrane koje proizvode toplotnu energiju kogeneracijom i distributivnu mrežu do mesta snabdevanja potrošača.</p> <p>2. Proizvođači, uključujući i termoelektrane koje funkcionišu kao jedinice za kogeneraciju, mogu da snabdevaju toplotnom energijom istu mrežu za distribuciju toplotne</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Aktivitetet në sektorin e energjisë termike</b></p> <p>Aktivitetet në sektorin e energjisë termike, të përcaktuara me këtë ligj, kryhen në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe akteve tjera nënligjore përkatëse të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Activities in the thermal energy sector</b></p> <p>Activities in the thermal energy sector, as defined in this law, shall be carried out in line with the Law on the Energy Regulator and other bylaws approved by the Energy Regulatory Office.</p>	<p>energije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Aktivnosti u termoeenergetskom sektoru</b></p> <p>Aktivnosti u termoeenergetskom sektoru, utvrđene ovim zakonom obavljaju se u skladu sa Zakonom o Energetskom Regulatoru i drugim relevantnim podzakonskim aktima donesenim od odobren Regulatorna Kancelarija za Energetiku.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Sthurja</b></p> <p>1. Ndërmarrjet e energjisë termike të integruara vertikalisht kryejnë aktivitetin e prodhimit, transportimit dhe shpërndarjes, si dhe furnizimit me funksione të ndara. Bartja e informatave ndërmjet këtyre aktiviteteve të ndara është e ndaluar, përveç nëse këto informata kërkohen për përmbushjen e detyrave të furnizuesit publik.</p> <p>2. Ndërmarrjet e energjisë termike të licencuara për aktivitetin e prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit ndajnë llogaritë e tyre të brendshme me qëllim të shmangies së diskriminimit, si dhe çrregullimit të konkurrencës.</p> <p>3. Ndërmarrjet e energjisë termike të integruara vertikalisht mbajnë kontabilitet të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Unbundling</b></p> <p>1. Vertically-integrated thermal energy enterprises perform generation, transportation and distribution, and supply activities, with separate functions. Transfer of information between these separate activities is prohibited, except when such information is requested to fulfill the duty of public supplier.</p> <p>2. Thermal energy enterprises licensed for generation, transportation, distribution and supply activities will have separate internal accounts, to avoid discrimination and distortion of competition.</p> <p>3. Vertically-integrated thermal energy enterprises shall have separate accounting</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Razdvajanje</b></p> <p>1. Vertikalno integrisana termoeenergetska preduzeća obavljaju delatnost proizvodnje, prenosa, distribucije i snabdevanja sa razdvojenim funkcijama. Prenos informacija između ovih razdvojenih delatnosti je zabranjena, osim ako su te informacije potrebne za izvršenje obaveza javnog snabdevača.</p> <p>2. Termoeenergetska preduzeća licencirana za delatnost prodaje, prenosa, distribucije i snabdevanja će razdvojiti svoje interne račune u cilju izbegavanja diskriminacije i narušavanja konkurencije.</p> <p>3. Vertikalno integrisana termoeenergetska preduzeća vode odvojeno računovodstvo za</p>

<p>ndarë veçmas për aktivitetet e furnizimit të konsumatorëve me tarifa të rregulluara dhe me çmime të parregulluara, si dhe për aktivitete që nuk kanë të bëjnë me energji termike.</p> <p><b>KAPITULLI III PRODHIMI I ENERGJISË TERMIKE</b></p> <p><b>Neni 7 Prodhimi i Energjisë Termike</b></p> <p>Prodhimi i energjisë termike kryhet nga ndërmarrjet e energjisë që posedojnë licencë për prodhim të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, ose nga persona juridikë apo fizikë që janë të liruar nga detyrimi për t'u pajisur me licencë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.</p> <p><b>Neni 8 Të drejtat e Prodhuesit të Energjisë Termike</b></p> <p>1. Prodhuesi i energjisë termike ka të drejtë :</p> <p>1.1. të shfrytëzojë gjatë procesit të prodhimit të energjisë termike, ato burime primare të energjisë, që i konsideron të përshtatshme, me kusht</p>	<p>books for the supply of customers, with tariffs regulated and unregulated prices and for activities not related to thermal energy.</p> <p><b>CHAPTER III THERMAL ENERGY GENERATION</b></p> <p><b>Article 7 Thermal Energy Generation</b></p> <p>Thermal energy generation shall be carried out by energy enterprises which hold generation licenses issued by the Energy Regulatory Office, or by legal or natural persons which are exempted from the obligation to obtain a license according to the Law on the Energy Regulator.</p> <p><b>Article 8 Rights of Thermal Energy Generators</b></p> <p>1. A thermal energy generator has the right to:</p> <p>1.1. use in the thermal energy generation process the primary energy sources which are considered most appropriate, provided that they are in</p>	<p>delatnost snabdevanja i potrošača sa tarife regulisanih i neregulisanih cene i za aktivnostikoje se ne odnose na toplotnu energiju.</p> <p><b>POGLAVLJE III PROIZVODNJA TOPLOTNE ENERGIJE</b></p> <p><b>Član 7 Proizvodnja Toplotne Energije</b></p> <p>Proizvodnju toplotne energije obavljaju energetska preduzeća koja poseduju licencu za proizvodnju izdatu od strane Regulatornog Ureda za Energiju ili pravna ili fizička koja su oslobođena od obaveze pribavljanja dozvole u skladu sa Zakonom o Energetskom Regulatoru.</p> <p><b>Član 8 Prava Proizvođača Toplotne Energije</b></p> <p>1. Proizvođač toplotne energije ima pravo:</p> <p>1.1. da u toku procesa proizvodnje toplotne energije koristi one primarne energetske resurse koje smatra najprikladnijim, pod uslovom da su u</p>
---	--	--

<p>që të jenë në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet teknike, teknologjike, mjedisore dhe të efijencës së energjisë;</p> <p>1.2. që stabilimentet përkatëse t'i kyçë në rrjetin e shpërndarjes sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe rregullat dhe kodet përkatëse të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;</p> <p>1.3. të lidhë kontratë për shitjen e energjisë termike sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;</p> <p>1.4. të transportojë energjinë termike përmes rrjetit të shpërndarjes; dhe</p> <p>1.5. të pajiset me njehsorë për matjen e energjisë termike, që hyn në rrjetin e shpërndarjes, të përcaktuara në Kodin e Matjes, si dhe të faturojë dhe arkëtojë pagesat e përcaktuara sipas kontratave për të gjitha shitjet e energjisë termike.</p>	<p>line with the technical, technological, environment and efficiency requirements and standards.</p> <p>1.2. to connect respective facilities in the distribution grid, in accordance with conditions set in this law, as well as relevant rules and codes, as adopted by the Energy Regulatory Office;</p> <p>1.3. conclude a contract for the sale of thermal energy in line with conditions defined with this law and approved regulations issued by the Energy Regulatory Office;</p> <p>1.4. transport thermal energy through the distribution network; and</p> <p>1.5 obtain thermal energy meters, of the energy entering the distribution network, as envisaged in the Metering Code, and bill and collect payments as defined in contracts for all thermal energy sales.</p>	<p>skladu sa tehničkim, tehnološkim i ekološkim zahtevima i standardima i sa zahtevima i standardima za energetsku efikasnost.</p> <p>1.2. da odgovarajuća postrojenja priključi na mrežu distribucije u skladu sa uslovima predviđenim ovim zakonom kao i pravilima i odgovarajućim kodeksima koje usvaja Regulatorna Kancelarija za Energetiku;</p> <p>1.3. da zaključi ugovor o prodaji toplotne energije pod uslovima utvrđenim ovim zakonom i relevantnim propisima donesenim od strane Regulatorna Kancelarija za Energetiku</p> <p>1.4. da vrši prenos toplotne energije kroz distributivnu mrežu, i</p> <p>1.5 da se opreme brojilima za merenje toplotne energije koja ulaze u distributivnu mrežu, predviđenim Mernim Kodeksima, kao i da fakturišu i naplaćuju račune koji su utvrđeni ugovorima o svim prodajama toplotne energije.</p>
---	--	---

<p align="center"><b>Neni 9</b> <b>Obligimet e Prodhuesit të Energjisë Termike</b></p>	<p align="center"><b>Article 9</b> <b>Obligations of Thermal Energy Generators</b></p>	<p align="center"><b>Član 9</b> <b>Obaveze Proizvođača Toplotne Energije</b></p>
<p>1. Prodhuesi i energjisë termike është i obliguar të:</p> <p>1.1. ushtrojë veprimtarinë në pajtim me kushtet e licencës të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë si dhe ligjet tjera përkatëse;</p> <p>1.2. ushtrojë veprimtarinë në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim që të sigurojë kontroll të përhershëm mbi ndikimin në mjedis;</p> <p>2. Për matjen e energjisë termike, prodhuesit përdorin pajisjet matëse përkatëse, sipas kërkesave teknike dhe kërkesave tjera të përcaktuara në Kodin e Matjes.</p> <p>3. Prodhuesi i energjisë termike me kapacitet të instaluar më shumë se 1 MW<sub>t</sub>, do t'i mbajë të dhënat për çdo orë të operimit të impiantit për një periudhë pesë (5) vjeçare. Këto të dhëna përfshijnë, të dhënat për kapacitetet prodhuese në dispozicion dhe rezervat e dedikuara, duke përfshirë kohën dhe sasinë e realizimit të prodhimit, por duke mos u kufizuar vetëm në to.</p>	<p>1.The Generator of the thermal energy is obliged to:</p> <p>1.1. exercise activities in accordance with license conditions determined in the Law on Energy Regulatory Office and other relevant laws.</p> <p>1.2. exercise its activities in accordance with the laws and regulations on environment protection, with the aim of ensuring permanent control on environment impact;</p> <p>2. For the metering of thermal energy, generators shall use relevant metering devices, in line with technical and other requirements defined in the Metering Code.</p> <p>3. Thermal energy generators with an installed capacity of over 1 MW<sub>t</sub>, will keep hourly records of the plant's operation for a period five (5) years. Such data shall include, but not limited to, data on the available generation capacity and dedicated reserves, including time and amount of the realization of generation.</p>	<p>1. Proizvođač toplotne energije je dužan da :</p> <p>1.1. obavljaju delatnost u skladu sa uslovima licence predviđenih Zakonom o Regulatornoj Kancelariji za Energetiku kao i drugim relativnim zakonima.</p> <p>1.2. obavlja delatnost u skladu sa relevantnim zakonima i propisima o zaštiti životne sredine u cilju da se osigura kontinuirana kontrola nad uticajima na životnu sredinu;</p> <p>2. Proizvođači za merenje toplotne energije koriste odgovarajuće merne uređaje, u skladu sa tehničkim zahtevima i drugim uslovima koji su utvrđeni u Mernom Kodeksu.</p> <p>3. Proizvođač toplotne energije sa instaliranim kapaciteom od preko 1 MW<sub>t</sub> će čuvati podatke o svakom satu rada postrojenja u periodu od pet (5) godina. Ovi podaci obuhvataju podatke o raspoloživim proizvodnim kapacitetima i namenskim rezervama, uključujući, ali ne ograničavajući se samo na vreme i obim ostvarene proizvodnje.</p>



<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Obligimet e prodhuesve për të ofruar energji termike</b></p> <p>Prodhuesit e energjisë termike me kapacitet më shumë se 1 MW<sub>t</sub>, të cilët ekzistonin dhe ishin në operim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar të shesin energjinë termike të prodhuar furnizuesit publik me tarifa të rregulluara në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, në rast se furnizuesit publik i nevojitet ajo energji për të përmbushur obligimet e veta si furnizues publik.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Obligations of generators to provide thermal energy</b></p> <p>Thermal energy generators with a capacity higher more than 1 MW<sub>t</sub>, which existed and were in operation until the entry into force of this law, are obliged to sell the generated thermal energy to the public supplier in regulated tariffs, in line with article 46 of the Law on the Energy Regulator, if the public supplier needs such energy to fulfill its obligations as a public supplier.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Obaveze proizvođača da isporučuju toplotnu energiju</b></p> <p>Proizvođači toplotne energije sa kapacitetom više od preko 1 MW<sub>t</sub>, koji su postojali i bili u funkciji na dan stupanja na snagu ovog zakona, dužni su da prodaju proizvedenu toplotnu energiju javnom proizvođaču po regulisanim tarifama u skladu sa članom 46 Zakona o Energetskom Regulatoru, ukoliko je javnom snabdevaču ta energija potrebna za izvršenje njegovih funkcija javnog snabdevača.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Rezervat e lëndëve djegëse</b></p> <p>1. Prodhuesi i energjisë termike i ngarkuar me obligim të shërbimit publik, duhet të mbajë rezerva minimale të lëndës djegëse të nevojshme për të mbajtur prodhim të vazhdueshëm dhe në rast nevoje të shtojë kapacitetin prodhues rezervë në mënyrë që të sigurojë furnizim të qëndrueshëm për konsumatorët.</p> <p>2. Shpenzimet e mbajtjes së minimumit të rezervave të lëndës djegëse dhe të kapacitetit prodhues rezervë trajtohen shpenzim operativ i prodhuesit që ka obligim t'i mbajë ato rezerva.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Fuel reserves</b></p> <p>1. Thermal energy generator tasked with the public supplier obligation, must keep minimum fuel reserves necessary to maintain a stable generation and, when needed, to increase its reserve generation capacity to ensure sustainable supply for customers.</p> <p>2. Costs of maintaining minimum fuel reserves and contingency generation capacity shall be treated as operational expenditures incurred by the generator obliged to maintain such reserves.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Zalihe goriva</b></p> <p>1. Proizvođač toplotne energije zadužen za obaveze javnog snabdevanja mora da održava minimalne zalihe goriva potrebne za održavanje kontinuirane proizvodnje u cilju da obezbedi stabilno snabdevanje potrošača.</p> <p>2. Troškovi održavanja minimalnih zaliha goriva i rezervnog proizvodnog kapaciteta vode se kao operativni troškovi proizvođača koji je dužan da održava te zalihe.</p>

